



Republika e Kosovë
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/04-47363 dt. 30/10 2020

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 23.10.2020, ora 10:00.
Mbledhjen e kryesoi Gani Podrimqaku-anëtar i KPF.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Komunës :Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Blerina Gashi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Nënkrjetari i Komunës- Nazmi Hasi Drejtori për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublatku.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të datës. 16.09.2020.
2. Raporti Financiar i Zhvillimit Të Buxhetit Janar Shtator 2020.
3. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 12-400-40369,të datës. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
4. Propozim Vendim shfuqizimin e Vendimit 12-400-40360, të dt. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
5. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave –banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
6. Propozim Vendim për këmbimin e pronave të paluajtshme (ndjesive të ndërtesave-banesave) në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
7. Propozim Vendim për shpronësimin e pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave –banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
8. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme të hekurudhave të Kosovës (Shoqëri Aksionare) për parcelat nr. 953-1,961-0,956-0, të cilat ndodhen në zonën kadastrale Drenas (Gllogoc).
9. Propozim Vendim për transfero të mjeteve nga projekti rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe rregullimi i sheshit të qytetit në projektin mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike.

10. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP-Drenicës, të cilat janë nënë menaxhimin e AKP-së, në zonën Kadastrale Korroticë e Epërme.
11. Të ndryshme.

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku: hapi mbledhjen e KPF, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës, i njoftoi anëtarët e KPF-së se kemi edhe një pike shtesë për rendin e ditës: 1. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP-Drenicës, të cilat janë nënë menaxhimin e AKP-së, në zonën Kadastrale Korroticë e Epërme.

Pasi nuk pati diskutime **tjera Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku:** - hodhi në votim rëndin e ditës së bashku me një pikë shtesë, prezent gjatë votimit ishin 5 anëtarë:

Për votuan 5 anëtar ,Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku: - hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të datës. 16.09.2020.

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku:** - hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 5 anëtarë:

Për votuan 5 anëtar, Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e dytë e rendit të ditës: 2 . Raporti Financiar i Zhvillimit Të Buxhetit Janar Shtator 2020.

Fjalën e merr drejtori i **Drejtorisë për Financim Shyqyri Bublaku për prezantim të raportit:-** Përshëndetje per te gjithë. Ky raport është përpiluar Janar-Shtator ku paraqitet si obligim ligjor çdo organizatë buxhetore ka obligim ligjor te raportojë të njoftoje bordin e drejtorëve. Komitetin për Politike dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, sa i përket periudhës ne kemi pasur raport nuk do isha ndalur ne detaje por ne pikat kryesore ,buxheti i komunës pas rishikimit ka arrite shumen **16.530.458** mije euro ku për paga janë **8.549.001** euro per mallra-shërbime **1.809.309** mije euro per shpenzime komunale **195.341** mije euro ndërsa per subvencione dhe transfere ka arrite shumen **496.593**. Buxheti per investime kapitale pas rishikimit ka arrite shumen **4.484.406** euro gjegjësisht është nje shume me e vogël se buxheti fillestar edhe kjo ka ndodhur për shkak te rishikimit mos realizimit te hyrave si ne nivelin qendrorë dhe ne nivelet lokale d.m.th. neper komuna nuk i ka trendët e planifikuara andaj edhe shuma është dashtë te behet rishikimi buxhetit është zvogëluar, kemi pasur edhe rezervën buxhetore e cila ka qene për Komunën e Drenasit qe ka qene e parapare për paga dhe mëditje nje shume e cila nuk është realizua dhe kemi parapare me e fut me investime kapitale për kete vit. Nëse e shikojmë realizimin e te hyrave vetanake te Komunës se Drenasit për periudhën te cilën po raportojmë, të hyrat direkte te Komunës per periudhën Janar-Shtator **610.968** ¹⁴ cent, shumë kjo qe është me e vogël se e planifikimi apo është vetëm **58.57%** me planin vjetor te të hyrave ndërsa me rritjen e kalumë nëse bëjmë një krahasim eshte **76.81%**. Nëse e shikojmë kto janë vetëm hyrat direktë qe i realizojmë drejtpërsëdrejti ne pa grande, pa donacione , pa burime te tjera te financimit, ndërsa nëse e shikojmë shumen totale sa është arrite te realizimit ka me shku ne **1.050.293** ^{c 14} cent, ka shkuar realizimi i te hyrave direkte dhe indirekte, ne i quajmë direkte ato qe i realizojmë ndërsa indirekte shumat te cilat vijnë prej grandeve performances donatoreve dhe kjo shume ka arrite **1 milione e 50 mije**. Këtu me poshtë e keni edhe buxhetin per drejtori per secilën drejtori per secilin program dhe nën program ku i kemi 20 programe dhe nën programe d.m.th. nuk kisha

mu ndal per secilin veq nese keni pyetje dikush prej juve, por do te shkojmë ne tabelën e fundit ku paraqitet buxheti d.m.th. per periudhën e zhvillimit te buxhetit per periudhën Janar-Shtator dhe sivjet kemi si ne kregjt Kosovën qe ka mungesa ne realizimin e te hyrave dhe shpenzimin e buxhetit sepse deri ne muajin Qershor nuk kemi me mundur asnjë projekt me shpall, asnjë tender me dhëne andaj edhe shpenzimi i atyre mjeteve ka me çalue e kemi ditur qysh prej fillimit te vitit, prej fillimit te pandemisë, sa i përket shpenzimit për periudhën për te cilën po raportojmë, buxheti i ndare per kete periudhe ka qene **13.670.839** ^{68 cent} ndërsa shpenzimi ka qene **8.358.300** ^{28 cent} **apo 61.14%** qe është me parametrat e dëshiruar dhe planin vjetor te shpenzimit te buxhetit ndërsa ne vitin **2019** është **50.56%** duke pasur parasysh buxhetin prej **16.530.458** euro ,kisha mu ndal tash me shpenzimin e kategorive te shpenzimeve d.m.th. per paga mëditje shpenzimi i buxhetit është **99.27%** për mallra shërbime **53.18%** ,shpenzimet komunale **93.03%** ,subvencione dhe transfere është **43.49%** dhe investime kapitale **18.70%** qe d.m.th. përqindja e përgjithshme është **61.14%**. Kjo është ne pika te shkurtra sa i përket shpenzimit te buxhetit per kete periudhe kohore ,nëse keni pyetje unë jam i gatshëm te përgjigjem.

Ka dikush diçka jo rekomandojmë për kuvend, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: 3. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 12-400-40369,të datës. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Fjalën e merr në zëvendësim të drejtorit **nënkryetari i Komunës së Drenasit Nazmi Hasi** për prezantim të propozim Vendimit: *Kuvendi i Komunës së Drenasit me datë 23.09.2020 ka miratuar Vendimin 12 Nr. 400-40369 për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave – Banesat)në zonën kadastrale në Gllogoc.*

Por MPL ne vendimin për ligjshmëri Nr. 020-706/1 të datës 05.10.2020, ka vlerësuar se Kuvendi i Komunës së Gllogocit duhet të rishqyrtoj këtë vendim dhe të nxjerr dy Vendime të ndara, Vendim për shpalljen e interesit publik dhe Vendim për shpronësim.

Andaj Kuvendi i Komunës së Drenasit do të rishqyrtoj edhe do të harmonizoj këtë vendim sipas kërkesës së MPL-së.

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku:** - hodhi në votim pikën e tretë të rendit e ditës prezent gjatë votimit ishin 5 anëtarë:

Për votuan 3 anëtar, Kundër nuk pati, 2- Abstenim

Kaloim te pika e radhës 4. Propozim Vendim shfuqizimin e Vendimit 12-400-40360, të dt. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit. Ka dikush diçka?

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku:** - hodhi në votim pikën e katër të rendit e ditës prezent gjatë votimit ishin 5 anëtarë:

Për votuan 3 anëtar, Kundër nuk pati, 2- Abstenim.

Kaloim te pika e pestë 5. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave –banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc). Ka dikush diçka?

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku:** - hodhi në votim pikën e pestë të rendit e ditës prezent gjatë votimit ishin 5 anëtarë:

Për votuan 3 anëtar, 2-Kundër , Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e 6. Propozim Vendim për këmbimin e pronave të paluajtshme (ndjesive të ndërtesave-banesave) në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku:** - hodhi në votim pikën e gjashtë të rëndit e ditës prezent gjatë votimit ishin 5 anëtarë:

Për votuan 3 anëtar, 2 Kundër , Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e shtatë 7. Propozim Vendim për shpronësimin e pronave të paluajtshme (ndjesive të ndërtesave –banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc). Ka dikush diçka?

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku:** - hodhi në votim pikën e shtatë të rëndit e ditës prezent gjatë votimit ishin 5 anëtarë:

Për votuan 3 anëtar, 2- Kundër , Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e tetë 8. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme të hekurudhave të Kosovës (Shoqëri Aksionare) për parcelat nr. 953-1,961-0,956-0, të cilat ndodhen në zonën kadastrale Drenas (Gllogoc). Ka dikush diçka?

Fjalën e merr në zëvendësim të drejtorit nënkryetari i Komunës së Drenasit Nazmi Hasi për prezantim të propozim Vendimit: Komuna e Drenasit/Gllogocit nëpërmjet Kuvendit Komunal ka miratuar Vendimin për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, ku është paraparë që në këtë pjesë të ketë ndërtim dhe zhvillim të infrastrukturës rrugore, ku do të bëhet zgjerimi i rrugës dhe zhvillimi i infrastrukturës përcjellëse në interes të qytetarëve të Komunës së Drenasit. Andaj qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të këtyre pronave të Hekurudhave të Kosovës SH.A, Fushë Kosovë.

Për procedurat e mëtejme do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit, konform dispozitave ligjore në fuqi.

Ekipi profesional i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka bërë inçizimin e kësaj pjese të pronës së shënuar më lartë ku do të bëhet realizimi i këtij projekti, për të cilën pjesë edhe janë nxjerrë kopja e planit dhe çertifikatat e pronësisë.

Ka dikush diçka? Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku:** - hodhi në votim pikën e tetë të rëndit e ditës prezent gjatë votimit ishin 5 anëtarë:

Për votuan 3 anëtar, Kundër nuk pati, 2- Abstenim .

Kaloim te pika e nëntë 9. Propozim Vendim për transfer të mjeteve nga projekti rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe rregullimi i sheshit të qytetit në projektin mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike. Ka dikush diçka?

Fjalën e merr drejtori i drejtorisë për Financim Shyqyri Bublaku për prezantim të propozim Vendimit:- Kemi pasur probleme me rrjedhjen e kanalizimeve dhe u deshtë shuma e cila ka qene e parapare me buxhet është harxhuar tash kemi ato problemet Komunale pse jem na pa mjete andaj është kërkuar qe te plotësohet buxheti mirëpo nuk e di sa mundemi me mbërri per shkak te situatës ,kohës se shkurt, ne me procedure e kemi ece por deri me dt 31.10.2020 kemi mundësi me bere zotim te mjeteve. Ky tranfer duhet me kalua për me muajt me realizua nuk e di sa kemi me muajt me mbërri qëllimi është i mire mos me pasur telashe.

Ka dikush diçka? Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku:** - hodhi në votim pikën e nëntë të rëndit e ditës prezent gjatë votimit ishin 5 anëtarë:
Për votuan 5 anëtar, Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e dhjetë 10. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP-Drenicës, të cilat janë nënë menaxhimit të AKP-së, në zonën Kadastrave Korroticë e Epërme.

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i mbledhjes, Gani Podrimqaku:** - hodhi në votim pikën e dhjetë të rëndit e ditës prezent gjatë votimit ishin 5 anëtarë:
Për votuan 3 anëtar, 2- Kundër, Abstenim nuk pati.

Fjalën e merr në zëvendësim të drejtorit **nënkryetari i Komunës së Drenasit Nazmi Hasi** për prezantim të propozim Vendimit: Shpallja me interes të përgjithshëm publik të këtyra pronave ka për qëllim bartjen e tyre nga menaxhimi i AKP-së në emër të Komunës së Drenasit, për realizimin e planit zhvillimor, ekonomik urbanistik dhe infrastrukturor 2020-2028.

Bazë juridike për bartjen e këtyre pronave në emër të Komunës së Drenasit është Ligji për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Ligji Nr.06/L-092, ku neni 27 i këtij ligji thot: **(E drejta e komunës për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga institucionet qendrore).**

Bartja e këtyre pronave në emër të Komunës është e domosdoshme për qytetarët e Komunës së Drenasit, për rritjen e mirëqenies socio-ekonomike.

Këto prona janë trajtuar në organet kompetente të Komunës dhe është dakorduar që kjo listë e parcelave duke e specifikuar gjendjen aktuale të tyre, arsyeshmërinë e Komunës së Drenasit të shfrytëzohen për nevoja të përgjithshme komunale, konform legjislacionit në fuqi.

Pas miratimit të këtij propozim vendimi, Kryetari i Komunës inicon procedurën e mëtejme për bartje konform dispozitave ligjore në fuqi.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka bërë inqizimet e këtyre pronave dhe ka nxjerrë kopje të planit dhe certifikata të njësive kadastrave.

Kaloim te pika e njëmbëdhjetë 11. Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i mbledhjes Gani Podrimqaku konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 36 min.

Drenas 23.10.2020

Procesmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku Subashi



Kryesuesi i Kuvendit


Labmot Halilaj